

| INTEGRIMI PA ADRESË |  |                                           |
|---------------------|--|-------------------------------------------|
| TITULLARI POLITIK   |  | STRUKTURA INSTITUCIONALE                  |
|                     |  | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
|                     |  | Drejtoria për Integrim Evropian           |
|                     |  | ?                                         |
|                     |  | Zyra për Integrim Evropian                |
|                     |  | Sekretariati për Integrim Evropian        |
|                     |  | Ministria për Integrim Evropian           |

QEVERIA E KOSOVËS KA REAGUAR NDAJ DEKLARATAVE FYESE TË ZYRTARËVE SERBË PËR VIKTIMAT E LUFTËS NË KOSOVË ■ FAQE 4-5

## Qeveria kërkon nga BE-ja dhe ShBA-ja t'i dënojnë deklaratat e zyrtarëve serbë për viktimat

Qeveria e Kosovës i ka cilësuar skandaloze deklaratat kër-cënuese të zyrtarëve të Serbisë për serbët që tregojnë se ku janë varrezat e shqiptarëve nëpër Serbi. Qeveria e Kosovës ka vlerësuar se kjo shfaq mungesë të thellë respekti për viktimat e luftës së fundit në Kosovë dhe tregojnë se Beogradi zyrtar që-limisht i ka mbuluar gjurmët e krimit. Ekzekutivi ka kërkuar që ShBA-ja dhe BE-ja ta dënojnë këtë mendësi politike. Ndërsa zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka deklaruar se liderët e Ballkanit duhet të përmbahen nga deklaratat të cilat mund të jenë në dëm të fqinjësisë së mirë dhe pajtimit



■ FAQE 4-5

## OSMANI: HOTI NUK PO ARRIN T'I KETË 61 DEPUTETË QË TË VOTOHET PROJEKTLIGJI PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE



Këtë të enjte pritet të mbahen dy seanca plenare në të cilat do të jenë sërish në rend dite Projektligji për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së dhe Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike. Kështu ka bërë me dije të hënën kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve për dështimin e Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike, ajo ka thënë se kryeministri Hoti nuk po arrin t'i ketë 61 deputetë që të votohet ky projektligj. Osmani ka theksuar se kjo qeveri nuk do të duhej të formohej fare ■ FAQE 3

## NË 24 ORËT E FUNDIT EDHE 41 RASTE ME COVID NË KOSOVË ■ FAQE 7

| Raste COVID-19 sipas komunave                | Lokalliteti       | Nr. i rasteve |
|----------------------------------------------|-------------------|---------------|
| Deçan, gjithësi: 1, sipas lokaliteteve:      | Strelci i Ullat   | 1             |
| Gjakovë, gjithësi: 6, sipas lokaliteteve:    | Gjakovë           | 6             |
| Gjilan, gjithësi: 1, sipas lokaliteteve:     | Berishtë          | 1             |
| Kamenica, gjithësi: 1, sipas lokaliteteve:   | Kamenicë          | 1             |
| Klinë, gjithësi: 1, sipas lokaliteteve:      | Klinë             | 1             |
| Mitrovicë, gjithësi: 1, sipas lokaliteteve:  | Mitrovicë Jugore  | 2             |
| Pajti, gjithësi: 1, sipas lokaliteteve:      | Chelvar i Poshtëm | 1             |
| Prishtinë, gjithësi: 1, sipas lokaliteteve:  | Prishtinë         | 1             |
| Prishtëri, gjithësi: 11, sipas lokaliteteve: | Prishtëri         | 11            |
| Skenderaj, gjithësi: 1, sipas lokaliteteve:  | Klinë e Poshtme   | 1             |
| Viti, gjithësi: 4, sipas lokaliteteve:       | Stajinë e Epërme  | 1             |
|                                              | Tarashkë          | 3             |
| Gjithësi                                     | 11 komuna         | 41            |

## AKTUALE



**XHA FEROVIC: BOSNJE DHE HERCEGOVINA MBËSHKET DIALOGUN NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË F. 2**

**KURTI: TË BURGOSURIT NË KOSOVË DALIN EDHE MË TË MLLEFOSUR SESA QË KANË HYRË F. 6**

**ZGJEDHEN PROREKTORËT E UNIVERSITETIT TË SHKENCËVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ F. 6**

## EKONOMI

**OEK-U KËRKON NGA DEPUTETËT MOS TA PËRKRAHIN HEQJEN E HOMOLOGIMIT F. 8**

**KRASNIQI ME AMBASADORIN ROHDE DISKUTOI PËR IMPORTIN E PRODUKTEVE GJERMANE F. 8**



## SPORT

**ZYRTARE: TOVËRLANI LARGOHET NGA FERONIKELI, KLUBI E FALËNDERON PËR KONTRIBUTIN F. 15**

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçishtë-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princsha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjiibiznesi.com  
info@kolegjiibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Maqedonia e Veriut sot vendos për hapjen e kufirit me Kosovën

SHKUP, 5 TETOR - Komisioni i Sëmundjeve Infektive i Maqedonisë së Veriut i ka propozuar qeverisë hapjen e kufijve me Kosovën, Serbinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, pa testin për koronavirus të njohur si PCR.

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, ka thënë se propozimi për këtë nismë rajonale do të diskutohet të martën në mbledhjen e qeverisë dhe se vendimi me gjasë do të jetë pozitiv. “Bëhet fjalë për nismë rajonale, jo të Maqedonisë së Veriut, pasi kemi një rajon të vogël, ndërsa shifrat thuajse janë identike. Me siguri se do të marrim vendim në qeveri, kemi debat kualitativ. Kjo do të ndihmojë edhe ekonomisht, por duhet të kemi kujdes. Ne nuk duam të jemi të izoluar nga rajoni. Nëse rajoni është i hapur, edhe ne duhet, se jemi shtet i vogël, i lidhur me rajonin. Ne marrim



vendime pozitive kur propozime të tilla bëhen nga ekspertët e Komisionit të Sëmundjeve Infektive”, ka deklaruar Zaev.

Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut ka njoftuar se propozimi i Komisionit të Sëmundjeve Infektive është marrë bazuar në

analizat epidemiologjike, sipas të cilave, për momentin nuk ka indikacione apo numër të lartë të rasteve me Covid-19 që janë sjell nga këto vende. “Bazuar në

të dhënat momentale, nuk ka rrezik për hapjen e kufijve”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ministri i Shëndetësisë i Kosovës, Armend Zemaj, e cilësoi lajm të mirë propozimin nga Komisioni i Sëmundjeve Infektive në Maqedoninë e Veriut. “Numri i të infektuarve në vendin tonë me Covid-19 nuk përbën rrezik dhe e përshëndes propozimin për hapjen e kufijve pa test PCR. Uroj që Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ta miratojë këtë propozim”, ka shkruar Zemaj në një postim në “Facebook”.

Shtetasit e Maqedonisë së Veriut aktualisht mund të lëvizin pa testin PCR vetëm në Republikën e Shqipërisë. Heqja e kufizimeve kufitare së voni është kërkuar edhe nga odat ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore dhe Oda Ekonomike e Kosovës.

## Xhaferoviq: Bosnje dhe Hercegovina mbështet dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

TIRANË, 5 TETOR (ER) - Bosnje dhe Hercegovina e mbështet dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që zhvillohet në Uashington dhe Bruksel dhe dëshiron të ketë një zgjidhje të qëndrueshme dhe të pranueshme, ka thënë në Tiranë anëtari i presidencës trepalëshe të Bosnjë dhe Hercegovinës, Shefik Xhaferoviq. “Bosnje dhe Hercegovina mbështet të gjitha iniciativat rajonale që respektojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të gjitha vendeve.

Gjithashtu, mbështesim lëvizjen e lirë të mallrave, qytetarëve, investimeve dhe kapitalit në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor”, ka thënë Xhaferoviq në një konferencë për media pas takimit me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta. Ai ka theksuar se Bosnja e ka regjimin më të ngushtë për lëvizjen e njerëzve me Kosovën dhe se dëshiron që këtë ta përmirësojë.

Ndërsa presidenti i Shqipërisë,



Ilir Meta, ka bërë me dije se ka inkurajuar anëtarin e presidencës trepalëshe që Bosnja t'i vazhdojë përpjekjet për zgjidhje pragmatike për njohjen e dokumenteve dhe lehtësimin e regjimit të vizave për shtetasit nga Kosova.

Meta dhe Xhaferoviq diskutuan edhe për mundësinë e rihapjes së ambasadave të Shqipërisë në Bosnje dhe anasjelltas, duke thënë se ky akt do t'i përmirësojë raportet dypalëshe.

Bosnje dhe Hercegovina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës.

Më 17 qershor presidenca trepalëshe e Bosnjës kishte shqyrtuar kërkesën e anëtarit të saj, Shefik Xhaferoviq, mirëpo vendimi nuk ishte miratuar pasi anëtari tjetër i presidencës, Millorad Dodik, kishte votuar kundër. Për kishte votuar edhe anëtari kroat i presidencës, Zheko Komshiq.

Vendimi në presidencën trepalëshe merret me konsensus të tre anëtarëve.

## Mes tensioneve dhe debateve, Kuvendi i Shqipërisë miraton Kodin e ri Zgjedhor

TIRANË, 5 TETOR - Ndryshimet në Kodin Zgjedhor ku përfshihet heqja e koalicioneve, ulja e pragut në 1 për qind, e drejta e kryetarit të partisë të garojë

deri në katër zona zgjedhore, por dhe renditja e kandidatëve nga kryetari i partisë, por me rirenditje pas numërimit, ka marrë miratimin nga

deputetët në Parlamentin e Shqipërisë.

Mësohet se për votuan 94 deputetë, ndërsa për ‘vulosjen’ në ligj të këtij Kodi Zgjedhor

nevojiteshin vetëm 84 vota. Kjo seancë ka pasur tensione dhe debate të shumta, ku nuk munguan as kërcënimet e Ilir Metës nga Presidenca.



# Osmani: Hoti nuk po arrin t'i ketë 61 deputetë që të votohet Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike

Këtë të enjte pritet të mbahen dy seanca plenare në të cilat do të jenë sërish në rend dite Projektligji për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së dhe Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike. Kështu ka bërë me dije të hënën kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve për dështimin e Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike, ajo ka thënë se kryeministri Hoti nuk po arrin t'i ketë 61 deputetë që të votohet ky projektligj. Osmani ka theksuar se kjo qeveri nuk do të duhej të formohej fare



**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 TETOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar se këtë të enjte do të mbahen dy seanca. Në një konferencë për media pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, ajo ka thënë se njëra seancë do të jetë vazhdim i pikave të papërfunduara dhe tjetra do të jetë seancë e re. “Këtë të enjte do ta kemi sërish Projektligjin për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së, gjithashtu Projektligjin për rimëkëmbjen

ekonomike. Propozim-rezolutën nga raportimi i kryeministrit për dialogun, propozim-rezolutën nga interpelanca e ministrit të Punëve të Brendshme si dhe votimin në parim për masat e përkohshme për ta luftuar efektin e pandemisë. Këto janë pesë pikat që nuk është arritur shumica e nevojshme. Po ashtu, do të kemi seancë të re e cila do ta përfshijë votimin e dy marrëveshjeve të reja”, ka deklaruar Osmani. Sa i përket votimit të Projektligjit për rimëkëmbjen

ekonomike, që ka dështuar pesë herë të votohet, Osmani ka theksuar se kjo është përgjegjësi e koalicionit që t'i bëjë votat e mjaftueshme në Kuvend. “Zoti kryeministër nuk po arrin t'i ketë 61 deputetë që votojnë në favor të nismave që qeveria e tij i sponsorizon. Pra, përgjegjësia është aty dhe askund tjetër”, ka thënë

Osmani, duke shtuar se “kur LDK-ja ka qenë në opozitë, ka thënë se është përgjegjësi e PAN-it që ta bëjë shumicën”. Ajo ka bërë me dije se të premten mund të ketë edhe një seancë, në të cilën kryeministri Avdullah Hoti do të raportojë për punën 100-ditore të tij. E pyetur nga gazetarët nëse vendi duhet të shkojë në

zgjedhje, Osmani ka thënë se ajo ka bërë thirrje qysh moti që të gjithë t'i kthejnë sytë kah populli. “Sikur të merrej parasysh qëndrimi im, kjo qeveri nuk do të duhej të formohej fare sepse nuk është vullnet i qytetarëve dhe unë vazhdimisht kam bërë thirrje që të gjithë të kthehemi te populli”, ka thënë Osmani.

## Deputeti grek: Greqia vazhdon të jetë përkrahëse e të gjitha proceseve të Kosovës

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të hënën deputetin grek Andreas Patsis, i cili është edhe anëtar i Partive Popullore Evropiane (EPP). Me këtë rast, kryeministri Hoti dhe deputeti Patsis biseduan për zhvillimet politike në vend, menaxhimin e luftës kundër pandemisë Covid-19, planin për rimëkëmbje ekonomike, procesin e dialogut final ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, i cili duhet të përfundojë me njohje reciproke, si dhe



aspiratat e qarta të Kosovës për integritet në struktura euroatlantike.

Po ashtu, kryeministri Hoti vlerësoi lart marrëdhëniet e mira ndërmjet Kosovës dhe

Greqisë si dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet dy vendeve,

me theks të veçantë në fushën ekonomike. “Roli mbështetës i Greqisë në rrugëtimin politik të vendit tonë, kryesisht në procesin e integritetit në struktura euroatlantike, si dhe bashkëpunimi ekonomik ndërmjet dy vendeve tona është tepër i rëndësishëm”, ka theksuar kryeministri Hoti. Deputeti grek Andreas Patsis falënderoi kryeministrin Hoti për pritjen dhe theksoi se Greqia vazhdon të jetë përkrahëse e të gjitha proceseve të Kosovës, duke i mbështetur në mënyrë aktive aspiratat e popullit të Kosovës.


## Britania e Madhe ndan dy milionë euro për Kosovën

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, ka bërë me dije se Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka vendosur që t'i ndajë 2 milionë euro përkrahje shtesë për ta ndihmuar popullin e Kosovës që të kthehet në normalitet. Abbott ka thënë se ky projekt do të fokusohet në

sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit. “Ky projekt do të implementohet nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe do të fokusohet në sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit. Përkrahja nga Mbretëria e Bashkuar do të ndihmojë në përmirësimin e ofrimit të kujdesit shëndetësor si dhe pjesëmarrje të sigurt

dhe përfshirëse në shkollim. Përmes këtij projekti, Mbretëria e Bashkuar synon që të sigurohemi që të gjitha komunitetet kanë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore dhe arsimore, përkundër Covidit, dhe se askush mos të mbetet mbrapa”, ka shkruar Abbott në llogarinë e vet në “Facebook”.





Qeveria e Kosovës ka reaguar ndaj deklaratave fyese të zyrtarëve serbë për viktimat e luftës në Kosovë

# QEVERIA KËRKON NGA BE-ja DHE SHBA-JA T'I DËNOJNË DEKLARATAT E ZYRTARËVE SERBË PËR VIKTIMAT

Qeveria e Kosovës i ka cilësuar skandaloze deklaratat kërcënuese të zyrtarëve të Serbisë për serbët që tregojnë se ku janë varrezat e shqiptarëve nëpër Serbi. Qeveria e Kosovës ka vlerësuar se kjo shfaq mungesë të thellë respekti për viktimat e luftës së fundit në Kosovë dhe tregojnë se Beogradi zyrtar qëllimisht i ka mbuluar gjurmët e krimit. Ekzekutivi ka kërkuar që ShBA-ja dhe BE-ja ta dënojnë këtë mendësi politike. Ndërsa zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka deklaruar se liderët e Ballkanit duhet të përmbahen nga deklaratat të cilat mund të jenë në dëm të fqinjësisë së mirë dhe pajtimit

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 5 TETOR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka reaguar ndaj disa deklaratave publike të zyrtarëve të lartë të Serbisë të cilët kanë shfaqur mungesë të thellë respekti për viktimat e luftës së fundit në Kosovë. Përmes një reagimi për media Qeveria e Kosovës këto deklarata i ka

quajtur skandaloze, të cilat fyejnë rëndë të gjitha viktimat e krimeve serbe. Sipas ekzekutivit, kjo tregon se Beogradi zyrtar qëllimisht dhe me vetëdije i ka mbuluar gjurmët e krimit. "Qeveria e Republikës së Kosovës shpreh zhgënjimin e thellë ndaj disa deklaratave publike të zyrtarëve të lartë të Serbisë, të cilët hapur vazhdojnë të shfaqin mungesë të thellë respekti për viktimat e luftës së

fundit në Kosovë, si dhe familjet e tyre, të cilat që dy e më shumë dekada vazhdojnë t'i kërkojnë me dëshpërim të afërmit e tyre të rrëmbyer nga forcat serbe. Këto deklarata skandaloze, përveçqë fyejnë rëndë të gjitha viktimat e krimeve serbe, dëshmojnë para botës se Beogradi zyrtar, gjatë gjithë këtyre viteve, qëllimisht dhe vetëdijshëm i ka mbuluar gjurmët e krimit, duke e mbajtur fshehur

vendndodhjen e varrezave masive në të cilat kanë përfunduar mijëra civilë të pafajshëm", është thënë në reagimin e Qeverisë së Kosovës.

Më tej, Qeveria e Kosovës ka kërkuar që edhe ShBA-ja dhe BE-ja ta dënojnë këtë mendësi politike. "Qeveria e Republikës së Kosovës e kundërshton këtë mendësi politike dhe presim që këtë ta bëjë edhe bashkësia ndërkombëtare, veçmas Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës si faktorë të pazëvendësueshëm të ndërtimit të paqes dhe të perspektivës euroatlantike të Ballkanit Perëndimor", ka vlerësuar qeveria, duke shtuar se ekzekutivi është i përkushtuar që të punojë për të ardhmen paqësore të rajonit. "Qeveria e Republikës së Kosovës është e vendosur të punojë me

përkushtim për një të ardhme paqësore të rajonit dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë fuqishëm me aleatët perëndimorë për integrimin sa më të shpejtë në familjen e madhe të vendeve të qytetëruara e demokratike euroatlantike, në të cilën nuk ka vend për urrejtje ndaj etnive të tjera", është thënë në fund të reagimit.

Ndaj këtyre deklaratave të zyrtarëve të lartë serbë të hënën ka reaguar zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, pasi është pyetur nga gazetarët për një gjë të tillë. Ai ka thënë se Bashkimi Evropian pret nga liderët në Ballkanin Perëndimor që të përmbahen nga deklaratat të cilat mund të jenë në dëm të fqinjësisë së mirë dhe pajtimit. "Do të duhej të ishte e qartë për të gjithë përfaqësuesit e vendeve të cilat kanë aspirata për t'u anëtarësuar në BE, se ata do të



duhej t'i përmbushin obligimet e tyre për t'i forcuar raportet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimin rajonal. Këto janë vlera të cilat i mbron dhe avancojnë BE-ja. Liderët politikë duhet vërtet të jenë shembull duke zgjedhur që të punojnë së bashku, ta promovojnë bashkëpunimin dhe klimën e besimit të ndërsjellë, respektit dhe mirëkuptimit, e jo të japin deklarata që shkojnë në të kundërtën, ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.

Stano ka thënë se në përgjithësi BE-ja nuk i komenton deklaratat e politikanëve, por ditët e fundit ka vërejtur disa deklarata që nuk shkojnë në drejtim të rritjes së mirëbesimit dhe pajtimit mes popujve të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Ditë më parë, për këtë çështje, ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, iu ka shkruar letër ambasadorëve të vendeve të Quintit, nga të cilët ka kërkuar që të dënohet gjuha ofenduese e zyrtarëve të lartë serbë ndaj viktimave. “Kërcënimet publike nga Ivica Dačić, ndaj serbëve të cilët tregojnë vendet ku fshihen trupat e viktimave shqiptare të Kosovës, kanë shkaktuar dhimbje të jashtëzakonshme për popullin e Kosovës e hapje të plagës së vjetër, veçanërisht për familjet e viktimave dhe atyre që ende rezultojnë të zhdukur 21 vjet pas

luftës. Për më tepër, thirrja ksenofobe e Aleksandar Vulinit ndaj shqiptarëve në deklaratën zyrtare për shtyp meriton dënimin tuaj të fuqishëm ndaj akteve të turpshme dhe shoviniste të Qeverisë së Serbisë”, është thënë në letër e kryediplomates. Ajo ka vlerësuar se që të njëjtat standarde të zbatohen kur e kaluara jonë tragjike nënçmohet dhe sulmohet përsëri nga vetë kryesit e saj. “Agresori dhe viktimat do të mund të kenë trajtim të barabartë vetëm atëherë kur të vendoset drejtësia për të gjitha mizoritë dhe krimet e së kaluarës. Pa këtë premisë trajtimi asimetrik është, për fat të keq, gjithmonë i favorshëm për agresorin. Ju ftoj ta dënoni ashpër gjuhën jashtëzakonisht ofenduese të qeverisë serbe, duke u mbështetur në bazamentin e fortë të paqes dhe sigurisë që ju keni siguruar për ne në Kosovë, por edhe në Serbi”, është thënë në këtë letër të ministres Haradinaj-Stublla.

Kjo thirrje e kryediplomates së Kosovës për bashkësinë ndërkombëtare që ta dënojë gjuhën nënçmuese të zyrtarëve të lartë serbë ndaj shqiptarëve ka nxitur reagimin e ministrit serb të Mbrojtjes, Aleksandar Vulin. Ai ka vazhduar ta përdorë termin nënçmues “shqiptar”, duke thënë se bashkësia ndërkombëtare mund të reagojë në lidhje me deklaratat të tij. “Se Haradinaj-Stublla turpërohet që është ‘shiptarkë’ nuk duhet të zemërohet në mua. Ashtu siç e quajnë veten do t'i quaj edhe unë, kur nga gjuha e tyre ta heqin fjalën ‘shqiptar’ edhe unë do t'i quaj ashtu si do ta quajnë veten. Deri atëherë do t'i respektoj adetet dhe gjuhën e tyre dhe ‘shqiptarët’ do t'i apostrofoj me respekt ashtu siç e quajnë veten ‘shqiptari’”, ka deklaruar Vulin.

Ditë më parë ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić, ka bërë disa deklarata që janë konsideruar kërcënuese për serbët që bëjnë të ditura lokacionet e shqiptarëve të varrosur në territorin e Serbisë. “Mos u merrni me amerikanët, gjermanët, turqit dhe gjithë të tjerët. Çfarë të bëjmë me serbët të cilët flasin budallallëqe të ndryshme, iu tregojnë shqiptarëve dhe kroatëve se ku janë të varrosur shqiptarët në gjithë Serbinë”, ka thënë ai për një televizion në Serbi.

Çështja e të pagjeturve është një prej temave për të cilën është diskutuar në takimet e fundit, të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Bashkëpunimi me strukturat ndërkombëtare të drejtësisë dhe procedimi i krimeve të luftës është një prej kushteve për integrimin evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky kusht pritet të përsëritet në paketën e zgjerimit dhe raportet vjetore të progresit të cilat Komisioni Evropian do t'i miratojë të martën.

# EPIK-u: Kosova, i vetmi vend në Ballkan pa strukturë institucionale për integrim evropian

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Instituti EPIK ka bërë me dije se sot (e martë) Komisioni Evropian do ta publikojë Pakon e Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor dhe Planin Investiv dhe Ekonomik për Rajonin. “Publikimi i Strategjisë së Zgjerimit dhe Raportit të Vendit është momentum më i rëndësishëm vjetor në kuadër të procesit integruar të çdo vendi të Ballkanit. Këto dokumente përbëjnë themelet e vlerësimit politik dhe teknik të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Qeveria e Republikës së Kosovës ka shuar Ministrinë e Integritimit Evropian (MIE) dhe ka bartur përgjegjësitë e MIE-së në kuadër të zyrës së kryeministrit. Ne kemi përshëndetur vendimin e qeverisë për riorganizimin e strukturës institucionale përgjegjëse për procesin integruar dhe një gjë të tillë e kemi rekomanduar në tetor të vitit 2019, në përputhje me përvojat më të mira të vendeve të rajonit dhe vendeve të cilat tani janë bërë shtetet anëtare të

BE-së”, është theksuar në komunikatën e Institutit EPIK.

Sidoqoftë, sipas EPIK-ut, qeveria edhe pas katër muajve nuk ka arritur ta ngrehë strukturën e re për integrim evropian. “Në mungesë të vendimit të kryeministrit për emërimin e një anëtare të kabinetit qeveritar përgjegjës për procesin integruar, agjenda evropiane vazhdon të trajtohet si çështje ad hoc dhe sekondare nga anëtarët e ndryshëm të kabinetit qeveritar. Kjo situatë ka krijuar konfuzion dhe përshtypjen se Qeveria e Kosovës nuk e sheh procesin integruar si një proces të rëndësishëm strategjik për vendin. Në këtë kontekst, publikimi i nesërm i Pakos së Zgjerimit dhe Planit Investiv dhe Ekonomik për rajonin e gjen Kosovën si të vetmin vend në rajon pa adresë politike dhe pa strukturë institucionale për integrim evropian”, theksohet në këtë komunikatë. EPIK-u ka vlerësuar se dështimi për ta ngritur strukturën e re institucionale për integrim

evropian është indikacion i mungesës së vëmendjes dhe përgjegjësisë politike për procesin i cili gëzon përkrahjen më të madhe të qytetarëve të Kosovës dhe është sinonim i unitetit të spektrit politik të Kosovës. “Ftojme kryeministrin e Republikës së Kosovës që urgjentisht ta emërojë njërin nga anëtarët e kabinetit qeveritar si titullar politik të procesit integruar të vendit dhe të prezantojë një plan të qartë të tranzicionit institucional të MIE-së drejt strukturës së re qeveritare. Mungesa e një plani eficient të tranzicionit do të vazhdojë të krijojë boshllëk politik dhe paqartësi institucionale duke dëmtuar kështu agjendën integruar të vendit. Publikimi i nesërm i Pakos së Zgjerimit duhet të shërbejë si momentum i reflektimit të gjithë spektrit politik dhe mundësi unifikimi politik për t'i avancuar reformat në rrugën tonë integruar”, është theksuar në komunikatën e Institutit EPIK.



## QKUK-ja pranon një donacion tjetër nga shteti italian

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 TETOR - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka pranuar donacionin e radhës, rëntgen për Laboratorin e Mikrobiologjisë në Klinikën Infektive, i ndërtuar me fondet e projektit “Mbështetje për sistemin shëndetësor të Kosovës”, nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AIC).

Donacioni, i cili kap vlerën e 55 mijë eurove, është dorëzuar të hënën nga ambasadori i Italisë në Kosovë, Nicola Orlando.

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, tha se pas përfundimit të disa formaliteteve, Laboratori i Mikrobiologjisë do ta fillojë punën shumë shpejt. “Ne e njoftuam ambasadorin dhe ministrin për planet tona. Kanë

mbetur edhe disa çështje pa u zgjidhur për fillimin e punës: statuti juridik i laboratorit, plotësimi me laborantë, që pritet të bëhet brenda 10 ditëve të fundit. Kështu që, brenda dy javëve planifikojmë ta fillojmë punën në laborator”, tha Krasniqi.

Pasi ka falënderuar shtetin italian për ndihmën e vazhdueshme, sidomos gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, bëri thirrje edhe një herë për kujdes të shtuar. “Le të jetë mesazh kjo ndihmë e miqve dhe partnerëve tanë, që ne duhet ta vazhdojmë rritjen e kujdesit këto ditë. Nuk duhet të kalojmë në nivel të mosdisiplinës dhe ta rëndojmë punën e profesionistëve shëndetësorë. Ta mbajmë maskën, higjienën dhe shumë më pak apo fare nuk do të kemi nevojë që aparaturat e reja të



përdoren në masë të madhe”, ka theksuar Zemaj.

Ambasadori italian Nicola Orlando ka përgëzuar institucionet e Kosovës për

menaxhimin e pandemisë deri tash, gjersa ka thënë se laboratori i ri do t'i ndihmojë shumë institucionet shëndetësore për ofrimin e

shërbimeve për pacientët. Laboratori i Mikrobiologjisë është inauguruar më 20 shkurt të këtij viti dhe kap vlerën e më shumë se 203 mijë eurove.

## Kurti: Të burgosurit në Kosovë dalin edhe më të mllëfosur sesa që kanë hyrë

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, bashkë me këshilltaren ligjore Furtuna Sheremeti kanë zhvilluar një bisedë me dr. Brunilda Pali, eksperte në fushën e drejtësisë restauruese në Belgjikë. Kurti ka bërë me dije se gjatë takimit kanë diskutuar mbi konceptin e drejtësisë restauruese dhe shembujt praktikë të shteteve që e kanë të integruar atë në sistemet e tyre (si Belgjika, Austria, Norvegjia, Gjeorgjia) si dhe mbi hapësirën që ekziston që drejtësia restauruese të aplikohet në Kosovë, duke u bërë pjesë e sistemit të drejtësisë. “Ndër të tjera, biseda u fokusua në mundësinë dhe përfitimet praktike që Kosova do të kishte me integrimin e drejtësisë restauruese në sistemin e drejtësisë.

‘Drejtësia restauruese’ ka lindur si paradigmë e re drejtësie në vitet ’70 si rezultat i humbjes së besimit në paradigmen e trajtim-rehabilitimit si dhe të



dënim-parandalimit, ‘zbulimit’ të viktimës si pjesëtar/e i/e rëndësishëm për procesin e drejtësisë, si dhe nga kritika e mbiburokratizimit dhe mbiprofesionalizimit të sistemit

të drejtësisë. Ajo i referohet çdo procesi që u mundëson të dëmtuarve nga krimi dhe atyre që janë përgjegjës për atë dëm, nëse bien dakord lirisht, të marrin pjesë në mënyrë aktive

në zgjidhjen e çështjeve që rrjedhin nga vepra penale, përmes ndihmës së një pale të tretë të trajnuar dhe të paanshme”, ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se një ndër

problemet kryesore në Kosovë është që të dënuarit dalin nga burgjet edhe më të mllëfosur sesa që kanë hyrë brenda për shkak të mungesës së vëmendjes në rehabilitimin dhe reintegrimin e tyre në shoqëri. “Viktimat, në anën tjetër, shpesh riviktimizohen nga procesi gjyqësor dhe rrallë gjejnë drejtësinë që kërkojnë sepse sistemi i drejtësisë në thelb nuk është ndërtuar për ta riparuar dëmin e shkaktuar nga krimi. Një qasje e tillë dritëshkurtër nuk i ndihmon shtetit dhe nuk kontribuon në uljen e nivelit të kriminalitetit (recidivizmi është në rritje), apo të sigurisë publike por, përkundrazi, e rritë atë. Si rezultat i kësaj është e rëndësishme jetike t'i gjejnë mënyrat më të mira të bashkëpunimit me ekspertë të fushës (nga brenda dhe jashtë) për integrimin e drejtësisë restauruese në sistemin dhe ndryshimin e kahut nga ajo retributive në restauruese”, ka deklaruar lideri i LV-së, Albin Kurti.

## Zgjedhen prorektorët e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

FERIZAJ, 5 TETOR (ER) - Këshilli Drejtues i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) në mbledhjen e mbajtur të hënën ka zgjedhur prorektorët e universitetit. Këshilli Drejtues me shumicë votash ka zgjedhur prof. dr. Bujar Pira, prorektor për

Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sigurim të Cilësisë, prof. as. dr. Rrahim Sejdiu, prorektor për Mësim, Shkencë dhe Çështje të Studentëve dhe prof. as. dr. Arben Tërstena, prorektor për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë. Rektori i UShAF-it, prof. dr.

Agron Bajraktari, ka falënderuar Këshillin Drejtues që votoi propozimet për prorektorë dhe tha se tanimë universiteti është i kompletuar nga ana menaxheriale dhe premtoi se do të bashkëpunojnë për të mirën e UShAF.



# Në 24 orët e fundit edhe 41 raste me Covid në Kosovë

**PRISHTINË, 5 TETOR (ER)** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 654 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 41 raste pozitive me

Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes me Covid (një rast nga spitali Gjilan dhe një rast nga spitali Prizren). Numri total i rasteve pozitive është 15 855 raste nga 70 873 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 632 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 73 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të

shëruarve deri më sot është gjithsej 13 929 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 294. Rastet pozitive me Covid në 24 orët e fundit janë nga komuna Prishtinë 11 raste, komuna Gjilan 9 raste, komuna Gjakovë 6 raste, komuna Viti 4 raste, komuna Mitrovicë 3 raste, komuna Pejë 3 raste dhe me nga një rast Deçan, Kamenicë, Klinë, Podujevë dhe Skenderaj.

| Raste COVID-19 sipas komunave                | Lokaliteti            | Nr. i rasteve |
|----------------------------------------------|-----------------------|---------------|
| Deçan, gjithsej: 1, sipas lokaliteteve:      | Strellc i Ulët        | 1             |
| Gjakovë, gjithsej: 6, sipas lokaliteteve:    | Gjakovë               | 6             |
| Gjilan, gjithsej: 9, sipas lokaliteteve:     | Bresalc               | 1             |
|                                              | Gjilan                | 8             |
| Kamenicë, gjithsej: 1, sipas lokaliteteve:   | Kamenicë              | 1             |
| Klinë, gjithsej: 1, sipas lokaliteteve:      | Sferkë                | 1             |
| Mitrovicë, gjithsej: 3, sipas lokaliteteve:  | Mitrovicë Jugore      | 2             |
|                                              | Zhabar i Poshtëm      | 1             |
| Pejë, gjithsej: 3, sipas lokaliteteve:       | Poçestë               | 3             |
| Podujevë, gjithsej: 1, sipas lokaliteteve:   | Llapashticë e Poshtme | 1             |
| Prishtinë, gjithsej: 11, sipas lokaliteteve: | Prishtinë             | 11            |
| Skenderaj, gjithsej: 1, sipas lokaliteteve:  | Klinë e Poshtme       | 1             |
| Viti, gjithsej: 4, sipas lokaliteteve:       | Sllatinë e Epërme     | 1             |
|                                              | Tërstenik             | 3             |
| Gjithsej                                     | 11 komuna             | 41            |

## MSh-ja shqyrton kërkesën për përfshirjen e personelit lokal shëndetësor në ‘pakon emergjente fiskale’



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**  
**PRISHTINË, 5 TETOR** - Nën organizimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka diskutuar lidhur me përgatitjet e fundit për përfshirjen e të gjithë personelit komunal shëndetësor në ‘Pakon Emergjente Fiskale’ si dhe përgatitjeve e shpërndarjes së vaksinës kundër gripit sezonal. Kryesuesi i Kolegjiumit, Bujar Gashi, ka informuar për përgatitjet e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP) lidhur me shpërndarjen e vaksinave kundër gripit sezonal, sipas

programit dhe kalendarit të vaksinimit të hartuar nga IKShP-ja. Në këtë diskutim është theksuar se, përkundër uljes së numrit të prekurve me Covid-19 në kohët e fundit, është me shumë rëndësi që grupet e rrezikuara të vaksinohen, meqë diagnostikimi i gripit sezonal me pandeminë e Covid-19, sëmundje që e shkakton koronavirusi, janë të ngjashme. Po ashtu, është thënë se kategoritë që duhet të vaksinohen në periudhën e gripave janë të gjithë personat e moshuar mbi 65 vjeç, si dhe personat me sëmundje kronike. Gjithashtu në këtë diskutim u tha se duhet të ketë një kujdes të theksuar që edhe punëtorët shëndetësorë të vaksinohen kundër gripit pasi do të jenë në

kontaktin e parë me pacientë, andaj imunizimi i punëtorëve shëndetësorë është i rëndësishëm. Në bashkëbisedim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Ministrinë e Shëndetësisë pikë diskutuese mbetet nëse komunat kanë mundësitë dhe kapacitetet e mjaftueshme që t’i përpilojnë listat e personave të kategorive të rrezikuara të cilët duhet të kenë prioritet në vaksinim duke marrë për bazë mosfunksionimin e sistemit informativ shëndetësor SISH. Ndërsa përmes përpjekjeve dhe angazhimeve të Asociacionit të Komunave të Kosovës, MSh-ja është në shqyrtim të kërkesës së vazhdueshme të Kolegjiumit të Shëndetësisë sa i përket përfshirjes së të gjithë personelit

shëndetësor lokal në ‘Pakon Emergjente Fiskale’ nga Qeveria e Republikës së Kosovës. “Kemi arritur një sensibilizim dhe mesazh të qartë për institucionet më të larta. Gjatë takimeve të rregullta të grupit punues Kryesuesi i Kolegjiumit sqaroi se nga ministri i Shëndetësisë kanë marrë premtimet se i gjithë personeli do të përfshihet në pakon emergjente, mirëpo mbetet ende pikëpyetje nëse duhet të shkojmë me një pagesë uniforme për të gjithë apo duhet të ketë një kategorizim të personelit në bazë të punës dhe rrezikshmërisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore”, ka thënë Bujar Gashi. Nga Ministria e Financave është e bërë me dije se do të jetë

shumë e vështirë kategorizimi i punonjësve shëndetësorë lidhur me pagesat i cili mbetet si opsion optimal. Dilema mbetet nëse një pagesë uniforme e të gjithë personelit do të shkaktojte pakënaqësi te një kategori e caktuar sikurse janë mjekët që të përfshihen në një nivel të përbashkët me të gjithë të tjerët. Kjo ende mbetet si pikëpyetje e cila do të shqyrtohet nga grupi punues deri tek aprovimi përfundimtar i Udhëzimit i cili rregullon këtë çështje, mirëpo rezultati parësor ende mbetet mosprivimi i të gjithë personelit tjetër shëndetësor duke marrë parasysh angazhimin e të gjithë stafit, pa dallim, duke qenë në vijë të parë për ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin në këtë situatë pandemie.

# OAK-u: Rënia prej 10-përqindësh e prodhimit vendor tregon gjendjen e rëndë në Kosovë

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka shprehur shqetësimin për gjendjen ekonomike të krijuar në vend si pasojë e pandemisë. “Tani kur jemi në dijeni se, pavarësisht prej vështirësive me të cilat po ballafaqohen qytetarët, bizneset dhe i gjithë vendi në Kuvendin e Republikës së Kosovës, edhe për të pestën herë me radhë që ishte pikë e rendit të ditës nuk është duke u shqyrtuar Pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike. Bëjmë të ditur sërish, se me këtë rast po vihet në rrezik shuarja e bizneseve, reduktimi drastik i numrit të punëtorëve si dhe zvogëlimi i të ardhurave të shtetit. Se gjendja në vend është

përkeqësuar jashtëzakonisht shumë, bëhet me dije veçanërisht pas publikimit të raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për Bruto Produktin Vendor për tremujorin e fundit”, është thënë në komunikatën e OAK-ut, duke shtuar se, sipas të dhënave të siguruar nga ASK-ja dhe analizës bërë nga OAK-u, del se sektorët të cilët janë prekur më së tepërmi gjatë këtij tremujori krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë ndërtimtaria, tregtia, akomodimi dhe shërbimet ushqimore, aktivitetet financiare si dhe bujqësia e pylltaria. Sa iu përket shpenzimeve, siç edhe vërehet, ato kanë shënuar ngritje. Pra, të



hyrat janë zvogëluar në përqindje relativisht të lartë përderisa

shpenzimet janë ngritur jashtëzakonisht shumë. Metodat

e shpenzimeve të cilat janë bërë radhiten në shpenzimet e konsumit final, shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake, shpenzimet e konsumit final të qeverisë, importi i mallrave dhe shërbimeve etj. Bazuar në këto statistika, vihet në pah se sektorët të cilët janë dëmtuar më së tepërmi janë ndërtimtaria, bujqësia, HORECA, tregtia etj. Andaj, ne si Odë e Afarizmit të Kosovës kërkojmë nga institucionet përgjegjëse që sa më parë të kalohet Pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike që sadopak të lehtësohet puna dhe funksionimi i bizneseve”, theksohet në këtë komunikatë.

## OEK-u kërkon nga deputetët mos ta përkrahin heqjen e homologimit

**EPOKA E RE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 TETOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) me anë të një letre të cilën e ka siguruar gazeta “Epoka e re”, i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe të gjithë deputetëve të legjislaturës së VII që mos ta përkrahin ndryshimin e Ligjit nr. 05/ L-123, në të cilin parashihet heqja e

homologimit për mjetet motorike. “OEK-u e sheh me shqetësim nismën e ndryshimit të Ligjit për Automjete, përmes të cilit synohet heqja e të ashtuquajturit ‘shërbim i homologimit’, që aplikohet në veçanti për mjetet rrugore që importohen”, thuhet në letrën e OEK-ut dërguar Kuvendit të Kosovës, letër kjo që mban firmën e kreut të këtij institucioni, Berat Bukiqi. Po në

këtë letër thuhet se: “OEK inkurajon deputetët e Kuvendit të Kosovës të mendojnë me qetësi dhe ta peshojnë argumentin se më e shtrenjtë është mbrojtja e publikut përmes mbrojtjes së shëndetit dhe parandalimit të importit të mbeturinave rrugore sesa efekti politik elektoral i heqjes së një kontrolli të domosdoshëm të automjeteve ta vënies së tyre në shërbim në trafikun e Kosovës”, theksohet në letrën e OEK-ut.



## Gjermania përgëzon Kosovën pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes energjetike ndërmjet ENTSO-E dhe KOSTT



PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Ambasada e Gjermanisë në Kosovë ka përshëndetur hyrjen në fuqi të marrëveshjes energjetike ndërmjet Rrjetit Evropian të Operatorëve të

Sistemit të Transmisionit (ENTSO-E) dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT). Sipas kësaj ambasade, ky është një

moment historik për Kosovën dhe për bashkëpunimin rajonal. “Ambasada gjermane përgëzon KOSTT-in dhe Qeverinë e Kosovës për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së

Lidhjes me Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (ENTSO-E). Marrëveshja më në fund mundëson krijimin e një zone të pavarur të kontrollit për

Kosovën. Ky është një moment historik për Kosovën dhe për bashkëpunimin rajonal”, thuhet në njoftimin e Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë.

# Krasniqi me ambasadorin Rohde diskutoi për importin e produkteve gjermane

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur në takim të hënën ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, me të cilin kanë biseduar për zhvillimin ekonomik, importin e produkteve gjermane, investimet dhe diasporën.

Ministri Krasniqi ka vlerësuar lart mbështetjen që shteti gjerman i ka dhënë Kosovës në periudha të ndryshme kohore nga ato më të vështirat e deri sot për zhvillimin ekonomik të vendit. “Një falënderim të veçantë e ka shteti gjerman për trajtimin që ua bënë qytetarëve të Kosovës që jetojnë dhe punojnë në Gjermani”, ka thënë Krasniqi. Ai e ka njoftuar ambasadorin se si Gjermani është në mesin e tri shteteve të para ku Kosova importon mallra nga atje.

Sa i përket nevojës për më shumë investitorë nga Gjermania, ministri i ka shpjeguar ligjin për investime strategjike dhe plotësimndryshimet që pritet të finalizohen. “Me ndryshimet që do të bëhen në ligjin për investime strategjike, Kosova do të jetë vendi me kushte më të favorshme për çdo investitor”, ka deklaruar ministri Krasniqi.

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, në diskutimet për fushën e

ekonomisë ka thënë se do të ishte më i kënaqur sikur edhe eksporti i produkteve nga Kosova drejt Gjermanisë të jetë më i madh. Sa iu përket remitancave nga mërgata shqiptare, që punojnë në Gjermani, ambasadori ka thënë se do të ishte mirë që ato të shndërrohen në investime.

Duke folur për ndikimin e pandemisë Covid-19, ambasadori Rohde është interesuar për paketën e Qeverisë së Kosovës për rimëkëmbje ekonomike. Më tej, ai shfaq shpresën e tij se Qeveria e Kosovës do të gjejë një kompromis me opozitën, në mënyrë që Kuvendi të mund ta miratojë draftligjin në seancën e radhës. Po të hënën ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur në një takim edhe ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly, me të cilin kanë biseduar për raportet tregtare, mundësinë e investimeve, rolin e diasporës shqiptare, turizmin dhe bujqësinë.

Ministri Krasniqi fillimisht ka falënderuar shtetin zviceran për mbështetjen e vazhdueshme që ky shtet i ka dhënë Kosovës. “Nuk duhet harruar që Zvicra ka qenë dhe është një vend mik i Kosovës, që e ka ndihmuar vendin tonë si para luftës, gjatë dhe pas luftës në rimëkëmbje



dhe në zhvillim”, ka thënë ministri Krasniqi. Duke folur për turizmin malor, ministri ka përmendur vendet me potencial të mrekullueshëm për skijim, si: Brezovica, Rugova, Brodi dhe Shala e Bajgores. “Zvicra si një

shtet i njohur për pista të skijimit dhe me një turizëm malor të zhvilluar mund t'i ndihmojë këto zona duke i bërë atraksion jo vetëm për qytetarët e rajonit, por edhe për vizitorë të shteteve të Evropës Perëndimore”, ka

theksuar ministri.

Ambasadori zviceran Thomas Kolly ka falënderuar ministrin për informacionet e prezantuar dhe ka shprehur gatishmërinë e shtetit helvetik për ta vazhduar mbështetjen për Kosovën.


## Ministri Mustafa përshëndeti lansimin e platformës AfroSoft

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Përmes një takimi virtual, të hënën u bë lansimi i platformës AgroSoft, me të cilin do të ndihmohen institucionet financiare në analiza sa më të sakta gjatë financimeve bujqësore.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, përshëndeti lansimin e platformës AgroSoft të cilën e vlerësoi si hap para drejt ekspeditimit të procedurave për kreditimin e agrobizneseve. Ministri Mustafa foli edhe për sfidat që ka pasur si ministria ashtu edhe bujqësia si sektor me rëndësi të veçantë për ekonominë e Republikës së Kosovës. Fokus të veçantë

ministri Mustafa vendosi mbi sfidat e bujqve të shkaktuara nga pandemia Covid-19, të cilave qeveria Hoti iu kundërpërgjigj me Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike.

Mes të tjerash, ministri Mustafa foli edhe mbi masterplanin e ujitjes së tokave bujqësore, projekt i ndihmuar nga Banka Botërore, me të cilin duhet të përfshihen në sistem të ujitjes 90 mijë hektarë tokë bujqësore. Lansimi i platformës Agrosoft u bë përmes një takimi virtual në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës.



## Kapen tre kallashnikovë në Vërmicë, gjatë tentimit për kontrabandim

PISHTINË, 5 TETOR (ER) - Njësit e Anti-kontrabandës të Doganës së Kosovës të hënën kanë zbuluar të fshehura në një automjet me targa të Shqipërisë armë, respek-

tivisht tre (kallashnikovë) AK-47 të çmontuar. Gjatë kontrolleve rutinore në pikëkalimin e Vërmicës oficerët doganorë kanë selektuar këtë automjet për kontroll.

Në automjet gjendeshin dy shtetas të Shqipërisë. “Gjatë kontrollit nën ulësen e bashkudhëtarit janë gjetur të çmontuara tri armët AK-47. Personat janë ndaluar si dhe

automjeti është kontrolluar hollësisht, derisa rasti është përcjell te Policia e Kosovës për hetime të mëtejme”, thuhet në njoftimin e Doganës së Kosovës.



# Dumoshi ndau 165 certifikata për të rinjtë nga Prishtina, të trajnuar për ndërmarrësi

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Në kuadër të programit të edukimit joformal që ka mbështetur Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në politikën e saj për përkrahjen dhe avancimin e rinisë në Republikën e Kosovës, të hënën janë certifikuar edhe 165 të rinj në fushën e ndërmarrësisë nga Komuna e Prishtinës.

E pranishme në këtë ngjarje ishte ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, e cila tha se përmes këtij projekti, i cili ka shtrirje në të gjithë Kosovën, po u mundësohet të rinjve të trajnohen për krijimin e planeve për bizneset e tyre me të cilat mund të fitojnë grante në Ministrinë e Kulturës. “Në total janë certifikuar 165 të rinj të cilët janë nga Komuna e Prishtinës,

respektivisht sot 113 vetëm nga qyteti i Prishtinës. Ky program është mjaft domethënës sepse po dalin ndërmarrës të rinj. Ky projekt ka shtrirje në gjithë Kosovën dhe interesimi i madh ka bërë që numri i paraparë për 400 ndërmarrës të rinj të përfundojë me 1 255 certifikime. Këta të rinj të cilët po certifikohen tash do ta hartojnë planin e biznesit dhe do të vijnë në ministri të konkurrojnë për grante dhe shumë shpejt ta fillojnë punën”, ka thënë ajo, duke theksuar se qeveria Hoti ka synim dhe objektiv rininë e vendit tonë. Ndërkaq Besnik Krasniqi nga “BSC Kosovo” ka falënderuar ministren Dumoshi për mbështetjen e dhënë, duke theksuar se trajnimi ka qenë mjaft intensiv.



## KEDS-i rrit sigurinë e furnizimit me rrymë në Mitrovicë

MITROVICË, 5 TETOR (ER) - Një objekt i ri në hyrje të Mitrovicës nga ana e Vushtrrisë tashmë ka ndryshuar për të mirë jetën e mitrovicasve. Aty tashmë janë vendosur stabilimente të reja dhe moderne për ta mundësuar operimin shumë më efikas të distribuimit të energjisë elektrike. Dhe, gjithçka është e digjitalizuar. Sipas një njoftimi të KEDS-it, më herët prishjet eventuale në rrjet duhet të lajmëroheshin nga dikush, përdërisa intervenimi merrte kohë si pasojë e këtyre procedurave mekanike. “Por, tashmë nënstationi i Shupkovcit reagon në mënyrë automatike në secilën të papritur dhe çdo gjë merret vesh në çastin që



ndodh. Kjo mundëson që intervenimi të jetë shumë më i shpejtë dhe sanimi i secilës të papritur të marrë kohë shumë më të shkurtër dhe më të shpejtë”, është thënë në njoftimin për media, duke u

shtuar se ky investim qindra mijëra eurosh i kryer nga KEDS-i ka sjellë siguri më të madhe të furnizimit me energji elektrike përnjëherë për gjysmën e qytetit të Mitrovicës.

## Vazhdojnë punimet e fazës së dytë të projektit të Downhillit

PRIZREN, 5 TETOR (ER) - Drejtorja për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik në Komunën e Prizrenit ka iniciuar procedurën për vazhdimin e punimeve të fazës së dytë të projektit të Downhillit. Me këtë aktivitet, shtigjeve aktuale që fillojnë nga rruga që lidhet me Shtëpinë

Malore dhe përfundojnë në Kala do t’iu shtohet edhe një shteg në gjatësi prej 2.8 km. Ky shteg, që do të rregullohet me mbështetjen e shoqatës “G 04”, do t’iu shërbejë çiklistëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë të cilët dëshirojnë ta shijojnë adrenalinën që ofron ky sport.



## Qendra për Punë Sociale në Shtime bëhet me dhomë miqësore për fëmijë



SHTIME, 5 TETOR (ER) - Në Qendrën për Punë Sociale (QPS) në Shtime është rregulluar “Dhoma Miqësore për Fëmijë” e cila do të shërbejë për këshillim të fëmijëve dhe shërbime për të rinjtë brenda kësaj qendre.

Organizata bamirëse amerikane LDS Charities, në bashkëpunim me Komunën e Shtimes, kanë rregulluar këtë hapësirë brenda QPS-së në vlerë prej 2 995 eurove, e cila përfshinë vizatime në muret e dhomës së shërbimeve, mobilim të dhomës, lodra, figura, lojëra, shikim të televizionit (programe për fëmijë), ndërsa ky projekt në fokus ka përmirësimin e shërbimeve sociale.

Lidhur me këtë projekt kanë qëndruar në QPS, nënkryetari i komunës, Rahman Jakupi, si dhe drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Musa Baftiu, ndërsa ky i fundit tha se përmes kësaj do të ofrohet ndihmë psiko-sociale për fëmijët që ballafaqohen me probleme familjare, por edhe me nevojat të veçanta si dhe një ambient më i përshtatshëm për punëtorin social që ta ketë më të lehtë ofrimin e shërbimeve. Po ashtu, drejtori i QPS-së, Burim Fazliu, në emër të stafit të qendrës falënderoi LDS Charities dhe Komunën e Shtimes për realizimin e këtij projekti, i cili përmirëson kushtet e punës dhe ofrimin të shërbimit në këtë qendër.

## Disa vende evropiane me masa të reja ndaj pandemisë

PARIS, 5 TETOR - Derisa numri i të infektuarve me Covid-19 po rritet, një pjesë e vendeve evropiane po marrin masa të reja kundër koronavirusit. Franca po shënon rritje të shpejtë të rasteve të reja. Gjatë fundjavës ky vend shënoi 30 000 persona të infektuar me koronavirusin e ri që e shkakton sëmundjen Covid-19. Autoritetet kanë ndërmarrë masa të reja në Paris. Aty restaurantet do të jenë në gjendje të qëndrojnë të hapura me protokolle të reja shëndetësore, orë të shkurtuara pune dhe do t'i regjistrojnë detajet e kontaktit të klientëve.

Puna nga shtëpia gjithashtu po inkurajohet fuqimisht.

Pacientët me koronavirus përbëjnë më shumë se 30 për qind të shtretërve të kujdesit intensiv.

Zhvillimet në Paris janë domethënëse sepse qytete të mëdhenj francezë, duke përfshirë Lille, Lyon, Grenoble



dhe Toulouse, po kalojnë pranë pragut maksimal të alarmit.

Në të gjithë botën vendet që dikur e kishin vënë nën kontroll përhapjen e virusit me bllokime dhe protokolle shëndetësore, tani po

përballen me një ringjallje shqetësuese, derisa ekspertët e shëndetësisë paralajmërojnë një vjeshtë dhe dimër të vështirë përpara.

Mbretëria e Bashkuar ka vendosur kufizime në tubimet

e njerëzve dhe pothuajse një e treta e popullsisë prej 66 milionë banorësh të vendit është nën masë më të forta lokale të izolimit.

Spanja ka vendosur Madridin dhe rajonin përreth tij - një

zonë me më shumë se 6 milionë njerëz - në bllokim të pjesshëm.

Mes një rritjeje të rasteve, qeveria çeke ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, duke filluar nga 5 tetori me masa të reja kufizuese.

Sipas Qendrës Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve, mesatarisht 303.3 njerëz në 100 000 banorë ishin infektuar me virus në Republikën Çeke në 14 ditët e fundit.

Autoritetet shëndetësore të Irlandës i rekomanduan qeverisë që vendi të zbatojë një bllokim të dytë mbarëkombëtar për katër javë.

Gjermania mbajti shkallën e infeksionit dhe vdekjeve nga Covid-19 në nivele më të ulëta krahasuar me vendet e tjera evropiane gjatë valës së parë në pranverë. Por, numri i të infektuarve po rritet përsëri dhe autoritetet po shqyrtojnë kufizime të mëtejshme.

## Shpallen fituesit e Nobelit për Mjekësi

LONDËR, 5 TETOR - Tre shkencëtarë që zbuluan virusin e Hepatitit C kanë fituar Çmimin Nobel për Mjekësi për vitin 2020. Fituesit janë: shkencëtari britanik Michael Houghton dhe studiuesit amerikanë Harvey Alter dhe Charles Rice.

Komiteti i Çmimit Nobel ka njoftuar se zbulimet e tyre "shpëtuan miliona jetë".

Ky virus është një shkaktar i zakonshëm i kancerit të mëlçisë dhe një arsye kryesore pse njerëzit kanë nevojë për një transplantim të mëlçisë.

Testet shumë të ndjeshme të gjakut kanë bërë që raste të tilla tani të eliminohen në shumë pjesë të botës dhe janë zhvilluar ilaçe efektive anti-virale. "Për herë të parë në histori, sëmundja tani mund të shërohet, duke rritur shpresat për çrrënjosjen e virusit të Hepatitit C nga bota", ka njoftuar komiteti i çmimit.

Sidoqoftë, virusi ende infektion 70 milionë njerëz në vit dhe vret rreth 400 000 të tjerë. Treshja do ta ndajë shumën e çmimit prej 10 milionë korona suedeze (rreth 1,1 milion dollarë).



## Turqia tërheq anijen kërkimore nga Mesdheu



ANKARA, 5 TETOR - Të hënën anije kërkimore turke u kthye në port nga ujërat e kontestuara pranë Qipros, sipas një faqeje interneti që merret me lëvizjet e anijeve në det. Flota detare turke kishte thënë muajin e kaluar se anija Yavuz do të qëndronte në ujërat mesdhetare lindore në jugperëndim të Qipros deri më 12 tetor.

Por, faqja e internetit "Vessel Finder" tha se anija filloi të tërhiqej nga rajoni i

diskutueshëm të dielën dhe hyri në një port turk të hënën.

Turqia s'ka bërë asnjë koment zyrtar.

Greqia dhe Turqia kanë pasur tradicionalisht marrëdhënie të tendosura dhe kanë qenë në mosmarrëveshje për dekada të tëra për një sërë çështjesh.

Dërgimi i anijes turke në Mesdhe për të kërkuar gaz natyror përshkallëzoi raportet mes tyre. Anëtarët e NATO-s, Greqia dhe Turqia, kanë

tronditur aleancën ushtarake duke organizuar ushtrime ushtarake rivale në muajin gusht për t'i mbështetur pretendimet e tyre territoriale dhe energjetike.

Konflikti filloi të lehtësohej kur këto vende ranë dakord muajin e kaluar për t'i rifilluar negociatat e drejtpërdrejta në Stamboll, për herë të parë që nga viti 2016.

Mirëpo ende asnjë datë për bisedimet nuk është njoftuar.

## Presidentja e Komisionit Evropian, në vetizolim

BRUKSEL, 5 TETOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, njoftoi se ka hyrë në vetizolim pasi ka qenë në kontakt me një person të

infektuar me Covid-19. Përmes një postimi në rrjetin social në "Twitter", von der Leyen ka bërë me dije se ajo mori pjesë në një takim, më 29 shtator, ku ishte i

pranishëm "një person i cili doli pozitiv". Presidentja e Komisionit Evropian ka theksuar se testi të cilin e ka bërë më 1 tetor ka rezultuar negativ dhe

se ajo do t'i nënshtrohet një testi tjetër më 5 tetor. Von der Leyen tha se ajo do të jetë në vetizolim deri më 6 tetor në mëngjes.








## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





# Challandesi flet për përballjen me Maqedoninë: Është skuadër e mirë, por nuk e ndërrojmë strategjinë e lojës

PRISHTINË, 5 TETOR (ER) - Bernard Challandes ka folur për përballjen më të rëndësishme në histori të Përfaqësueses së Kosovës përballë Maqedonisë së Veriut. Trajneri zviceran i Dardanëve e ka lavdëruar kundërshtarin e ditës së enjte, duke thënë se ka një skuadër të mirë me lojtarë që luajnë në Ligën e Evropës. “Futbollistët e tyre luajnë në Ligën e Evropës. Pra, bëhet fjalë për një kombëtare shumë të mirë, por besoj se edhe ne kemi një ekip të mirë”, ka thënë Challandes.

Trajneri zviceran tha se Maqedonia luan lojën e njëjtë si të Kosovës, kur dardanët luajnë mirë. “Nëse ndalemi dhe flasim për lojën e tyre,

duke qeshur mund të themi se Maqedonia e bën lojën e njëjtë me Kosovën kur luan mirë. Ka futbollistë kualitativë, kërkojnë ta kenë posedimin e topit, duan të luajnë në krahë. Pa fije dyshimi mund të them se është ekip mjaft i mirë”, ka thënë ai.

Challandesi i ka shikuar disa ndeshje të kundërshtarit të radhës dhe thotë se i ka studiuar ata. “Maqedonia e Veriut ka një ekip të mirë, ia kam shikuar ndeshjet. Ka bërë lojë të mirë me Armeninë, e sidomos me Gjeorgjinë”, është shprehur ai.

Challandesi deklaroi se edhe përkundër mungesave që ka në radhët e veta, nuk do ta ndërrojë filozofinë e lojës.



“Kemi alternativa për t’i zëvendësuar mungesat, edhe pse jo shumë. Por, në sulm

nuk kemi alternativë të duhur të Muriqit. Filozofinë e lojës nuk do ta ndërrojmë edhe

nëse nuk luan Vedat Muriqi. Nuk e kemi as Rashicën”, ka deklaruar Challandes.

## Zyrtare: Tovërlani largohet nga Feronikeli, klubi e falënderon për kontributin

DRENAS, 5 TETOR - Afrim Tovërlani ka paralajmëruar largimin nga Feronikeli pas humbjes së pësuar nga Drita 1-2. Trajneri prishtinas tha se do t’i ofrojë dorëheqjen kryetarit të klubit Naser Ramaj dhe ajo është pranuar. Ka qenë Feronikeli që ka konfirmuar se ka ndarë rrugët me trajnerin Tovërlani duke e falënderuar atë për kontributin e dhënë në klub. “Ashtu siç edhe u deklarua pas ndeshjes me Dritën, trajneri Afrim Tovërlani ‘Toki’ ka ndarë rrugët me Feronikelin. Pas ndeshjes, Tovërlani tha se do ta propozojë dorëheqjen nga klubi në takim me presidentin dhe kryesinë dhe një gjë e tillë edhe ndodhi. Pas diskutimeve ‘Toki’ e pa të arsyeshme që kjo ndarje e rrugëve është në të mirë të të dyja palëve.



Tovërlani erdhi te Feronikeli gjatë sezonit të kaluar dhe tani ndërpritet bashkëpunimi pas pesë xhirove të para të sezonit 2020-21. Feronikeli i uron

shumë fat në rrugëtimin e tij të ri dhe se ai është gjithmonë i mirëpritur në klubin tonë”, thuhet në njoftimin e klubit nga Drenasi.

## Gjilani fiton me rezultat bindës ndaj Arbërisë

GJILAN, 5 TETOR - Gjilani e ka mposhtur Arbërinë me rezultat 3-1 në kuadër të javës së pestë në Superligën e Kosovës. Gjilanasit e filluan mjaft mirë ndeshjen, duke sulmuar në drejtim të portës kundërshtare, mirëpo mysafirët ishin stoikë në mbrojtje. Por, në minutën e 28 Arbëria kaloi në epërsi me anë të Dior Zabërgjës që shënoi nga distanca. Skuadra e promovuar në këtë edicion në elitën e futbollit të Kosovës nuk arriti ta mbante edhe gjatë

epërsinë, pasi Gjilani i barazoi shifrat në 1-1 me anë të Gramoz Kurtajt (43’).

Pjesa e dytë ishte përsëri e dominuar nga vendësit që përmbytën rezultatin me anë të Edison Kqikut që shënoi në minutën 60. Për ta vulosur fitoren e Gjilanit u përkujdes Darko Nikaç që realizoi në minutën e 81-të nga një superasistim i Kqikut për 3-1. Pas javës së pestë, Gjilani është në vendin e tretë me tetë pikë, aq sa ka edhe Arbëria në të dytin.



## Enis Gavazaj i bashkohet FC Prishtinës

PRISHTINË, 5 TETOR - Prishtina ka njoftuar se ka transferuar Enis Gavazaj, i cili edhe në të kaluarën ishte pjesë e saj. Mesfushori 25-vjeçar ka luajtur në skuadra si Rosalare, Skënderbeu, Yenislej,

Dinamo Minsk dhe, së fundmi, te Kukësi. Gavazaj është shprehur shumë i lumtur që u rikthye te Prishtina, mirëpo ka pranuar se skuadra ka ndryshuar shumë që nga koha e tij e parë.

“Mesfushori ofensiv i krahut, Enis Gavazaj, 25 vjeç, rikthehet në Prishtinë pas shtatë vjetësh. I transferuar si talent i madh nga Liria në janar të vitit 2012 si 17-vjeçar, me FC Prishtinën për një

vit e gjysmë pati zhvilluar 22 ndeshje zyrtare. Pas turneut U19 në Dortmund, Gavazaj ishte transferuar te skuadra belge, Gent”, thuhet në njoftimin e FC Prishtinës.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REBUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA FERIZAJT – OPSTINA UROSEVAC – MUNICIPALITY OF FERIZAJ  
NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “ STACIONI I AUTOBUSËVE “ SH.A.



Mbështetur në dispozitat e nenit 21 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 13 të ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike , neni 183 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqërit tregtare , të Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale “ Stacioni i Autobusëve “Sh.a. Bordi i Drejtorëve I N.P.L. “Stacioni i Autobusëve “sh.a. në Ferizaj shpall:

Më :05.10.2020

## K O N K U R S

**1.Kryeshef Ekzekutiv të N.P.L. “ Stacioni i Autobusëve “ sh.a. ( 1)**

### Përshkrimi i detyrave dhe Përgjegjësi

- Kryeshefi Ekzekutiv do të ketë autoritet për të lidhur kontrata, në pajtueshmëri me ligjin , aktet tjera nënligjore dhe me Statutin e Ndërmarrjes N.P.L. “ Stacioni i Autobusëve “ sh.a. duke i'u nënshtruar vetëm kufizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve ,  
Biznesi , detyrat dhe organizimi I ndërmarrjes duhet të kryhet sipas direktivave , mbikëqyrjes dhe përgjegjësi të Kryeshefit Ekzekutiv në pajtueshmëri me Statutin e Ndërmarrjes NPL “ Stacioni I Autobusëve “ sh.a.dhe akteve tjera nënligjore të ndërmarrjes dhe vendimeve të Bordit të Drejtorëve ,
- Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e ndërmarrjes të cilat nuk janë përgjegjësi e Bordit të Drejtorëve , Komisionit të Auditimit , do të vendosen nga apo sipas direktivave dhe përgjegjësi të Kryeshefit Ekzekutiv ,
- Kryeshefi Ekzekutiv ka autoritet të punësoj apo të largoj nga puna stafin e ndërmarrjes , përveç atyre që janë kompetencë ekskluzive e Bordit të Drejtorëve ,
- Kryeshefi Ekzekutiv këshillon dhe asiston bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë dhe planeve strategjike afatgjata,
- I dorëzon sipas pozitës së tij dhe përgjegjësi të Bordit të Drejtorëve drafte të dokumenteve që parashikohen sipas Ligjit per Ndermarrjet Publike ,
- I ofron kurdo që është e nevojshme dhe së paku një (1) here ne tre muaj, Bordit të Drejtorëve raporte për transaksione kryesore të ndërmarra nga ndërmarria dhe për vendimet kryesore të nxjerra nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve te ndermarrjes ,
- I dorëzon , nën përgjegjësinë e tij , Bordit të Drejtorëve , dokumente , letra dhe informacione në lidhje me të gjitha çështjet e perfshira në agjendën e mbledhjeve ,
- Themelon dhe rishikon hierarkinë dhe strukturën organizative të ndërmarrjes ,
- Të marr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme ,

**MANDATI** : Kryeshefi Ekzekutiv zgjidhet me mandate 3 vjeçar .

**PAGA** : Në pajtim me politikën e kompenzimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

### KUALIFIKIMI DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

Sipas nenit 17, pika 17,3 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike , kandidatët për tu zgjedhur Kryeshef Ekzekuiv , duhet të plotësojnë këto kushte :

- Të ketë përgatitje universitare ,
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në menaxhim ,
- Të posedojë aftësi dhe shkathtësi profesionale për të punuar në mënyrë të sukseshme në një shoqëri multi etnike ,
- Të ketë aftësi për të kryer detyrat e punës në situatë të qetë dhe nën presion ,

### KUSHTET

Kandidatët të cilët do të përzgjidhen në pozitën e lartcekur në N.P.L. “ STACIONI I AUTOBUSËVE “ sh.a. duhet :

- Të mos jenë të denuar dhe nën hetime ,
- Të mos kenë bërë shkelje të Kodit të Etikës për standard dhe sjellje profesionale.

### KUSHTET PËR APLIKIM

Kandidatët për Kryeshef Ekzekutiv në N.P.L. “ STACIONI I AUTOBUSËVE “ sh.a. në Ferizaj duhet ti dorëzojnë këto dokumente :

- Dëshmine për kualifikimin profesional ,
- CV-në
- Letër motivimi ,
- Dëshminë për përvojën e punës
- Çertifikatën e lindjes ,
- Çertifikatën që nuk është nën hetime ,
- Deklaratën nën betim ( formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit te dokumentacionit )

Aplikuesi duhet të përgatisë deklaratën nën betim , në të cilën deklaron se ai/ajo I përmbush kushtet e kualifikimit , pavarësinë dhe përgatitjen profesionale , çdo përgënjeshttrim material , qoftë i qëllimshëm apo nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër përmendur , do të rezultoj me diskualifikim te menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet te jetë në zarf I mbyllur dhe të dorëzohen në zyrat e Ndërmarrjes Publike Lokale “ STACIONI I AUTOBUSËVE” sh.a. në Ferizaj

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga data 05.10.2020 deri më 19.10.2020 ,në ora 16 : 00.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Albrim Bytyqi

REPUBLIKA E KOSOVËS – REBUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA FERIZAJT – OPSTINA UROSEVAC – MUNICIPALITY OF FERIZAJ

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “ STACIONI I AUTOBUSËVE “ SH.A.



U skladu sa odredbama člana 21. Zakona br.03 / L-087 o javnim preduzećima, člana 13 Zakona br.04 / L-111 o izmenama i dopunama Zakona br.03 / L-087 o javnim preduzećima, član 183 Zakon br. 02 / L-123 o trgovinskim društvima, Statut lokalnog javnog preduzeća "Autobuska stanica" a.d. Odbor direktora L.J.P. "Autobuska stanica" a.d. u Uroševcu objavljuje:

Datum: 05.10.2020

## K O N K U R S

**1. Izvršni načelnik L.J.P. "Autobuska stanica" a.d. (1)**

### Opis zadataka i odgovornosti

- Izvršni načelnik ima ovlašćenje da zaključi ugovore, u skladu sa zakonom, i druge podzakonske akte i Statut preduzeća L.J.P. "Autobuska stanica" a.d. poštujući samo ograničenja utvrđena od strane Odbora direktora,
- Biznis, zadaci i organizacija preduzeća mora se izvršiti u skladu sa smernicama, nadzor i odgovornosti generalnog direktora u skladu sa Statutom L.J.P. preduzeća "Autobuska stanica" A.D. i drugih akata preduzeća i odlukama Upravnog odbora,
- Sva pitanja koja se odnose na poslovanje kompanije koja nisu u nadležnosti Upravnog odbora, Komisije za reviziju, će biti uspostavljena od strane ili u skladu sa smernicama i odgovornosti izvršnog načelnika,
- Izvršni načelnik ima ovlašćenje da zapošljava ili razrešava osoblje preduzeća, osim onih koje su isključiva nadležnost Odbora direktora,
- Izvršni načelnik savetuje i pomaže Upravnom odboru u definisanju dugoročne strategije i strateških planova,
- Podnosi, prema svojoj poziciji i odgovornosti odbora direktora, nacrt dokumente predviđene Zakonom o javnim preduzećima,
- Pruža kad god je to potrebno, a najmanje jedan (1) na svaka tri meseca, Upravnom odboru izveštaja o velikim transakcijama od strane kompanije i glavne odluke koje su donete od strane rukovodstva u vezi sa poslovnom rukovodstvom i radi na preduzeće,
- Pod svojom odgovornošću podnosi odboru direktora, dokumente, dopise i informacije o svim pitanjima koja su uključena u dnevni red sastanaka,
- Uspostavlja i revidira hijerarhiju i organizacionu strukturu preduzeća,
- Da prisustvuje svim generalnim sastancima,

**MANDAT**: Izvršni načelnik se bira sa mandatom od 3 godine.

**PLACTA**: U skladu sa politikom kompenzacije koju odobrava Odbor direktora.

### KVALIFIKACIJA I PROFESIONALNA PRIPREMA

U skladu sa članom 17. stav 17.3 Zakona 03 / L-087 o javnim preduzećima kandidati da bi bili izabrani za izvršni načelnik, moraju ispunjavati sljedeće uslove:

- Da imaju univertytetsku pripremu,
- Imati najmanje 5 godina iskustva menadžmenta,
- posedovati profesionalne veštine i veštine za uspešno delovanje u multietničkom društvu,
- Da ima sposobnost obavljanja radnih zadataka u mirnoj situaciji i pod pritiskom,

### USLOVI

Kandidati koji će biti izabrani na pomenutoj poziciji u L.J.P "Autobuska stanica" a. d. treba:

- da ne budu osuđeni i pod istragom,

- da nisu prekršili etički kodeks za standardno i profesionalno ponašanje.

### USLOVI ZA APLICIRANJE

Kandidati za izvršnog načelnika u L.J.P. "Autobuska stanica" a.d. u Uroševcu treba dostaviti ove dokumente:

- Certifikat o profesionalnoj kvalifikaciji,
- Biografiju
- Pismo motivacije,
- Dokaz radnog iskustva
- Izvod rođenja,
- Certifikat da nije pod istragom,
- Izjava pod zakletvom (obrazac koji se popunjava u trenutku podnošenja dokumentacije).

Podnosilac aplikacije mora pripremiti izjavu pod zakletvom da on / ona ima adekvatnu kvalifikaciju, nezavisnost i stručnu spremu, nikakvu materijalnu lažno predstavlanje, da li je to namerno ili iz nehata ili materijalne promene u informacijama pomenutih u gornjoj izjavi, rezultirati u neposrednoj diskvalifikaciji.

Dokumentacija mora biti u zapečaćenom kovertu i dostavljena u kancelarije Lokalnog javnog preduzeća "Autobuska stanica" a.d. u Uroševcu

Rok za prijavu je otvoren 15 dana od 05.10.2020. Do 19.10.2020. u 16:00 časova.

Predsedavajući Odbora direktora

Albrim Bytyqi



Në pajtim me nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Paneli për përzgjedhjen e anëtarëve joekzekutivë të Bordit të BQK-së, publikon:

Shpallje

Për plotësimin e dy (2) pozitave të anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitet apo çështje juridike;
- Njohuri në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojnë kushtet sipas nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidateve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedh nga një individ për secilën pozitë. Miratimi dhe emërimi për këto pozita do të bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84 paragrafi 27, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org) ose në dorë në zarf të mbyllur në arkivin e BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33 në Prishtinë, ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (shënim: për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së), Rruga Garibaldi nr. 33,1000 Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për aplikim është 21 tetor 2020, në orën 16:00.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për intervistë.

# Lume's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



U skladu sa članom 38. Zakona br. 03/ L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo (CBK), Komisija za izbor neizvršnih članova Odbora CBK-a, objavljuje:

Oglas

za popunjavanje dva (2) položaja neizvršnih članova Odbora Centralne banke Republike Kosovo

Zahtevani profil:

- Osoba sa integritetom i univerzitetskom pripremom;
- Najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Znanje u stvaranju i praćenju sprovođenja važnih politika vezanih za misiju, ciljeve i zadatke CBK-a;
- Specifično ispuniti uslove iz člana 40. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u;
- Poznavanje engleskog i drugih jezika predstavlja prednost.

Imenovanje će trajati pet godina počevši od datuma imenovanja.

Spisak kandidata kvalifikovanih od strane Komisije biće poslat Skupštini Republike Kosovo, koja će izabrati po jednog pojedinca za svaki položaj. Usvajanje i imenovanje za ove položaje izvršiće Predsednik Republike Kosovo u skladu sa članom 84. stav 27. Ustava Republike Kosovo i članom 38. stav 2. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u.

Zainteresovani kandidati moraju predati CV sa pojednostima i motivacionim pismom preko elektronske adrese: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org) ili predati u zatvorenoj koverti u arhivi CBK-a, ulica Garibaldi br. 33, u Prištini, ili putem pošte na adresu CBK-a: Centralna banka Republike Kosovo (napomena: za položaj neizvršnog člana Odbora CBK-a), ulica Garibaldi br. 33,1000 Priština, Kosovo.

Zadnji rok za prijavu je 21. oktobar 2020. godine u 16:00 časova.

Samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa biće pozvani na intervju.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Kam Trade” SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 70711923.

► Blerta Maliqaj, e lindur më 02.02.1987, shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit “Besila” me nr. 70944642.

► N.N.T. “Avi-Com” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 80633947.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN  
OPSTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr: 3-111-48285  
Datë: 05-10-2020

#### DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 4 pika 1, në bazë të nenit 32 të ligjit për zyrtarë publik nr 06/L-114 në bazë Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

#### **K O N K U R S** Për plotësimin e vendit të punës

##### Dy (2) Mjek të Përgjithshëm në QKMF-Lipjan.

##### Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Ofron mbrojtjen primare shëndetësore për pacientin dhe familjen duke respektuar kodin e mirësjelljes.
2. Bën diagnozën initiale dhe trajtimin e sëmundjes.
3. I përgjigjet nevojave të QKMF-së dhe punkteve të tjera në KPSH.
4. Referon tek specialisti, nëse është e domosdoshme.
5. Kryen shërbime të shëndetit riprodiktiv, kujdesit antenatal dhe postnatal.
6. Shërbime shëndetësore për fëmijë.
7. Promovon edukimin shëndetësor në shoqëri.
8. Trajton lëndimet e vogla.
9. Kryen vizita shtëpiake kur është e domosdoshme.
10. Gjatë punës së tij i asistojnë infermierët.
11. Kryen edhe punë të tjera nga lëmi i Kujdesit Primar Shëndetësor nëpër punkte të tjera shëndetësore në Lipjan, me kërkesën e menaxherit dhe Drejtorit të QKMF-së.
12. Për punën e tij i përgjigjet stafit menaxhues të QKMF-së dhe DSHPS-së.

##### Kushtet dhe kriteret :

Fakulteti i Mjekësisë – Drejtimi i Përgjithshëm  
Licenca nga Ministria e Shëndetësisë.  
Certifikata Shëndetësore.  
Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan.  
Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime.  
Leternjoftimi kopje

##### Aftësitë:

Të ketë aftësi komunikimi.  
Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën.  
Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë.  
Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.

##### Paga mujore:

Koeficienti: 7.2

##### Puna Provuete tre muaj (3)

Aplikacionet mundë të merren në zyrën për shërbime me qytetarët, sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën zyrë bashkë me dokumentet për konkurrim.

##### Vërejtje:

Dokumentet e pranuar nuk kthehen, ndërsa dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit, ueb faqen e Komunës si dhe në tabelën e shpalljeve.

Drejtoresha e DSHPS-së  
Dr. Merita Bytyqi



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN  
OPSTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Br: 3-111-48285  
Datum: 05-10-2020

#### DIREKTORAT ZAZDRAVSTVA I SOCIJALNO ZAŠTITU

Na osnovu clana 8 Zakona Rada Br. 03/L-212, clana 4 tačka 1 na osnovu clana 32 zakona o javnim slubenicama Administrativno Upustvo Br. 07/2017 za uredenje procedure konkursa u javnom saktoru, člana 49 tačka 49.2 Statuta Opštine Lipljana, Direktor Zdravstva za Socijalnu Zaštitu obavljuje:

#### **K O N K U R S** Za dopunu radnog mesta

##### Dva (2) Opšti Doktora u GCPM -Lipjan

##### Zadaci i odgovornosti:

1. Pruža primarnu zdravstvenu zaštitu pacijentu i porodici poštujući kodeks ponašanja.
2. Obavlja inicijalnu dignozu i lecenje bolesti.
3. Odgovara potrebama GCPM -e i drugih radnih mesta u NZK
4. Daje upustva kod specijalista, ako je potrebno.
5. Obavlja usluge reproduktivnog zdravlja, antenatalnu i postnatalnu negu.
6. Zdravstvene usluge za decu.
7. Promovise zdravstvo obrazovanje u drustvu.
8. Leči manje povrede.
9. Obavlja kućne posete kada je potrebno.
10. Tokom njihov rada asistiraju infermier.
11. Obavlja i druge poslove iz oblasti primarne Zdravstvene Zaštite u drugim zdravstvenim ustanovama u Lipljanu, na zahtev rukovodioca i direktora MFMC-a.
12. Za njihov rad odgovara se menadžersko osoblje GCPM i DZSB

##### Uslovi i kriterijumi:

Medicinski Fakultet – Opsti pravac  
Licenca iz Ministarstvo Zdravstva.  
Certifikat Zdravlja.  
Certifikat da nije pod nije pod istragom Osnovnog suda Prištine u organiku Lipljanu.  
Podvrda iz Policije da nije pod istragom.  
Kopje liqnekarte

##### Sposobnosti:

Imati komunikacijske veštine.  
Imati sposobnost vodenja nezavisnog rada uz poštovanje zakona kao i etike.  
Sposobnost organizovanja rada i izvršavanja gore opisanih zadataka.  
Da poseduje vestine i personalne kvalitete.

##### Mesečna plata:

Koeficient: 7.2

##### Probni Rad tri meseca (3)

Aplikacije mogu se dobiti u kancelariju za službeni sa građane, sportel br. 3 i podnese na istom kancelariji zajedno sa dokumentacijom za konkurisanje.

##### Primedba:

Primljeni dokumentaci se ne vraćaju, ali nekompletirani dokumenti neće biti pregledani.

Konkurs je otvoren 15 dana nakon objavljivanja u medijama, web sajtu Opštine kao i u tabeli objavljivanja.

Direktorica DZSB  
Dr. Merita Bytyqi



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

Nr: 3-111-48281  
Datë: 05-10-2020



KOMUNA LIPLJAN  
OPSTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

#### DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 4 pika 1, në bazë të nenit 32 të ligjit për zyrtarë publik nr 06/L-114 në bazë Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

### **KONKURS**

Për plotësimin e vendit të punës

#### NJË (1) SPECIALIST I PEDIATRISË NË QKMF-LIPLJAN

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Udhëheq dhe organizon punën në njësinë konsultative - pediatrike në QKMF.
2. Mban përgjegjësi për kontrollimin, hulumtimin, diagnostikimin, trajtimin (përcjellje të vazhdueshme të pacientit, po ashtu është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të regjistruara në dokumentacionin dhe në evidencë shëndetësore gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore që përmbajnë të dhëna për identitetin personal të banorit, diagnozën dhe trajtimin dhe udhëzon infermieret për trajtim.
3. I përgjigjet situatave emergjente dhe gjendjeve të jashtëzakonshme në çdo kohë dhe kërkon mbështetje në rast të situatave emergjente.
4. Bënë kontrollime specialiste pediatrike të pacientëve me udhëzim të mjekut.
5. Merr pjesë në mbledhjet të cilat i flon shefi i mjekësisë familjare ose Drejtori e në të cilat shqyrtohen tema të ndryshme profesionale apo çështje organizative.
6. Pediatrit duhet të merr pjesë në edukimin e vazhdueshëm profesional të organizuar në QTMF dhe bënë vlerësim për të specifikuar nevojat për trajnimin dhe zhvillimin profesional përmes koordinimit të QTMF-se ose Drejtorit të QKMF-se në trajnimet e organizuara nga QZHMFI - MSII.
7. Është përgjegjës për të zbatuar detyrat sipas ligjeve në fuqi dhe akteve nënligjore të institucionit shëndetësor që janë Statuti i QKMF-se, aktvendimet, urdhëresat tjera lëshuar nga DSHPS-se.
8. Kryen edhe punë tjera në kuadër të profesionit fushë veprimtaria e tij me kërkesë të Drejtorit të QKMF-se.
9. Për punën e veti përgjigjet shefit të mjekëve, Drejtorit të QKMF-se dhe Drejtorit të DSHPS-se.

#### **Kushtet dhe kriteret :**

Fakulteti i Mjekësisë - Drejtimi i Pediatrisë  
Licenca nga Ministria e Shëndetësisë.  
Certifikata Shëndetësore.  
Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan.  
Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime  
Letërnjoftimi kopje

#### **Aftësitë:**

Të ketë aftësi komunikimi.  
Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën.  
Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë.  
Të ketë shkathësi dhe kualitete personale.

#### **Paga mujore:**

**Koeficienti: 8.4**

#### **Puna Provuese tre muaj (3)**

Aplikacionet mund të merren në zyrën për shërbime me qytetarët, sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën zyrë bashkë me dokumentet për konkurrim.

#### **Vërejtje:**

Dokumentet e pranuar nuk kthehen, ndërsa dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit, ueb faqen e Komunës si dhe në tabelën e shpalljeve.

Drejtoresha e DSHPS-së  
Dr. Merita Bytyqi



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

Br: 3-111-48281  
Datum: 05-10-2020



KOMUNA LIPLJAN  
OPSTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

#### DIREKTORAT ZA ZDRAVSTVAO I SOCIJALNO ZAŠTITU

Na osnovu clana 8 Zakona Rada Br. 03/L-212, člana 4 tačka 1 na osnovu clana 32 zakona o javnim slubenicima, Administrativno Upustvo Br. 07/2017 za uredjenje procedure konkursa u javnom saktoru, člana 49 tačka 49.2 Statuta Opštine Lipljana, Direktorat Zdravstva za Socijalnu Zaštitu obavljuje:

### **KONKURS**

Za dopunu radnog mesta

#### Jedan (1) PEDIATRISKI SPECIJALIST-LIPLJAN

Zadaci i odgovornosti:

1. Upravlja o organizuje rad u konsultsko-pedijatrikoj jedinici na GCPM-e.
2. Snosi odgovornost za kontrolu, istraživanje, dijagnostiku, lečenje (kontinuirano praćenje pacijenta), je takode odgovoran za tačnost podataka registrovane u dokumentaciji i dokazima o zdravlju tokom pružanja zdravstvene usluge koje sadrže lične podatke identiteta stanovnika, dijagnoza i lečenje i vodi infermiere za lečenje.
3. Odgovarajući emergentne situaciju na vanredne situacije i zahteva pomoć u hitnim slučajevima.
4. Vršiti specijalističko-pedijatrijske preglede pacijenata uz uputu lekara.
5. Učestvuje u sastancima koje saziva šef porodične medicine ili Direkcija, u kojima se razgovara o raznim profesionalnim temama ili organizacionim pitanjima
6. Pedijatar treba učestvovati u kontinuiranom stručnom obrazovanju koji se organizuje u QTMF -u vrši procene radi preciziranja potreba za obukom i profesionalnim razvojem preko koordinatora QTMF-a ili direktora GCPM-e u obuci koju organizuje RCPM - MZ.
7. Odgovaran je za izvršavanje svojih zadatke prema važećim zakonima i podzakonskim aktima zdravstvene institucije koji su Statut GCPM -a, odluke i druge naredbe koje izdaje DZSZ.
8. Obavlja i druge aktivnosti u okviru profesije - svoju oblast delatnosti na zahtev direktora GCPM-a.
9. Za svoj rad odgovoran je šefu lekara, direktoru GCPM -a i direktoru DZSZ -a.

#### **Uslovi i kriterijumi:**

Medicinski Fakultet - Smer pedijatrije  
Licenca iz Ministarstvo Zdravstva.  
Certifikat Zdravlja.  
Certifikat da nije pod nije pod istragom Osnovnog suda Prištine u organiku Lipljanu..  
Podvrda iz Policije da nije pod istragom.  
Koje licekarte.

#### **Sposobnosti:**

Imati komunikacijske veštine.  
Imati sposobnost vodenja samostalnog rada uz poštovanje zakona kao i etike.  
Sposobnost organizovanja rada i izvršavanja gore opisanih zadataka.  
Da poseduje vestine i personalne kvalitete.

#### **Paga mujore:**

**Koeficient: 8.4**

#### **Probni Rad tri mesec (3)**

Aplikacije mogu se dobiti u kancelariju za sluzbeni sa gradane, sportel br. 3 i podnese na istom kancelariji zajedno sa dokumentacijom za konkurisanje.

#### **Primedba:**

Primljeni dokumenti se ne vraćaju, zatim nekompletirani dokumenti neće biti pregledani.

Konkurs je otvoren 15 dana nakon objavljivanja u medijama, web sajtu Opštine kao i u tabeli objavljivanja.

Direktorica DZSB  
Dr. Merita Bytyqi